


Komitetet për komunitete (KK) 2018

Komitetet për komunitete janë mekanizma komunalë të përbërë nga përfaqësues të komuniteteve që jetojnë në komunë dhe këshilltarë të kuvendit komunal. Të gjitha komunitetet që banojnë në një komunë të caktuar duhet të kenë së paku një përfaqësues në KK. Ata kanë mandat të sigurojnë që të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen përmes shqyrtimit dhe dhënies së rekomandimeve për politikën dhe veprimet komunale, dhe duhet të takohen të paktën një herë në muaj. Dokumentet kryesore që rregullojnë krijimin dhe funksionimin e KK-ve janë Ligji për vetëqeverisjen lokale (Nr. 03 / L-040, 2008), Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komisioneve të përhershme në komunë, i ndryshuar e plotësuar gjatë periudhës raportuese me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së nr. 02/2018, Udhëzuesin dhe Termat e referencës për KK-të.

Themelimi & Funksionimi

Komitetet për komunitete janë themeluar tashmë në të **38** komunat e vendit




KK-të që takohen rregullisht.

* KK-të që nuk janë takuar rregullisht në vitin 2018: Kamenica dhe Mitrovica Jugore.

Komitetet e papërfaqësuar


Ndonëse secili komunitet që banon në komunë duhet të përfaqësohet në KK, disa komunitete nuk janë të përfaqësuar. Komunitetet më të përfaqësuar janë turqit dhe boshnjakët në nëntëmbëdhjetë (19) komuna.

Qasja në burime/kushte të punës adekuate*



*Siç vlerësohet nga kryesuesit e KK-ve, (p.sh. transporti, kompjuterët, hapësira për zyra, telefonat).

Përfaqësimi gjinor në anëtarësinë e KK-ve




Performanca në vitin 2018


Numri i KK-ve që i realizojnë detyrat themelore*

(Sipas monitorimeve të rregullta të ekipeve në terren të OSBE-së dhe rishikimeve të periodike specifike nga ekipet në terren, si edhe raporteve që kanë nxjerrë komunat)


Nxjerrja e rekomandimeve për çështje specifike në lidhje me mbrojtjen/promovimin e të drejtave të komuniteteve për organet komunale




Dhënia e udhëzimeve për organet komunale për mbrojtjen/promovimin e të drejtave të komuniteteve




Rishikimi i politikave, praktikave dhe aktiviteteve komunale




Këshillimi dhe/ose bashkërendimi me zyrën komunale për komunitete dhe kthim për zgjedhjen e projekteve në dobi të komuniteteve




Aranzhimi i mundësive për komunitetet për të marrë pjesë në hartimin e strategjive dhe politikave përkatëse (duke përjashtuar komunat njëetnike, përkatësisht Parteshin e Junikun)



Monitorimi dhe raportimi në kuvend komunal lidhur me zbatimin e projekteve për komunitete




Rishikimi i politikave, praktikave dhe aktiviteteve komunale në lidhje me buxhetin (komuna e Ranillugut nuk është përfshirë në vlerësim ngaqë mbledhja e parë e KK-së për vitin 2018 u mbajt pas rishikimit të buxhetit)



■ Po
■ Jo

*Detyrat e përcaktuara me kuadrin ligjor dhe të politikave që monitorohen rregullisht nga OSBE-ja

Numri i detyrave themelore të realizuara për secilën komunë



Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) ofron mbështetje për përmirësimin e pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset e vendimmarrjes e qeverisjes si dhe në institucione. Në suazat e këtyre përpjekjeve, OSBE-ja e monitoron rregullisht punën e mekanizmeve komunale për mbrojtjen e komuniteteve. Këto fletushka informuese kanë si qëllim t'u ofrojnë institucioneve përkatëse komunale dhe atyre të nivelit qendror tregues që mund t'u ndihmojnë për t'i identifikuar mangësitë në respektimin e kritereve ligjore.